



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:145024
Datë: 16.11.2023
Numri i dokumentit: 04930918

C.nr.4079/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Greta Ibraj, në çështjen juridike kontestimore të E. S. - B., nga Prishtina, ndërtesa "E", Hyrja xxxx, Kati xx, Banesa nr.xx, me numër personal xxxx, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat M. N., me adresë fshati Hajvali, Komuna e Prishtinës, rr. "N. K.", Objekti xxx Construction, Hyrja xx, Kati x, Lokali xx, kundër të paditurit A. B., nga O., rr. "W." nr.xx, me objekt shqyrtimi zgjidhje e martesës, besim i fëmijëve, vendosje e kontaktit dhe pagesë e alimentacionit, jashtë seancës gjyqësore, më datë 16.11.2023, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditëses E. S. – B., nga Prishtina, e parashtruar me datë 03.07.2023, kundër të paditurit Ardit Behrami nga Obliqi, me objekt shqyrtimi zgjidhje e martesës, besim i fëmijëve, vendosje e kontaktit dhe pagesë e alimentacionit.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.
- III. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në Gjykatë përsëri.

A r s y e t i m

Paditësja E. S. B., përmes përfaqësuesit të autorizuar, më datë 03.07.2023, në këtë Gjykatë, ka parashtruar padi kundër të paditurit A. B., me objekt shqyrtimi zgjidhje e martesës, besim i fëmijëve, vendosje e kontaktit dhe pagesë e alimentacionit.

Gjykata, më datë 07.08.2023 ka nxjerrë aktvendim me të cilin e ka obliguar të paditurin që të paraqesë përgjigje në padi. Së bashku me aktvendimin në fjali i ka dorëzuar të paditurit edhe padinë me të gjitha shkresat e bashkëngjitura.

Pala e paditur, përmes të autorizuarës L. J. – H., avokate në Prishtinë, më datë 31.08.2023 ka paraqitur përgjigje në padi.

Më datë 02.11.2023, paditësja E. S. B., përmes të autorizuarit të saj, pranë kësaj Gjykate e ka dorëzuar parashtrësën për tërheqjen e padisë, me arsyetimin se palët ndërgjyqëse tanimë janë

pajtuar dhe jetojnë së bashku me fëmijët e tyre, andaj edhe nuk kanë kurrfarë interesi që të vazhdohet me procedurën për zgjidhjen e martesës.

Sipas nenit 261 par.2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (tutje: “LPK”), përcaktohet se: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”.*

Ne rastin konkret, meqenëse i padituri ka paraqitur në Gjykatë përgjigje në padi, Gjykata konform dispozitës së lartcekur, i ka dërguar të njëjtit njoftimin se ka të drejtë që brenda afatit prej 7 ditësh të jap pëlqimin për tërheqjen e padisë. Me po këtë njoftim, i padituri është njoftuar se në rast se nuk deklarohet brenda afatit të dhënë, do të konsiderohet se i njëjti e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Njoftimin e Gjykatës, i padituri, përmes të autorizuarës së tij, e ka pranuar më datë 07.11.2023, çka vërtetohet nga fletë dërgesa për dorëzim personal, e bashkëngjitur në shkresat e lëndës. Duke qenë se brenda afatit ligjor të dhënë, i padituri nuk është deklaruar lidhur me tërheqjen e padisë, kjo Gjykatë konsideroi se i njëjti e ka dhënë pëlqimin, e rrjedhimisht rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore të konstatohet e tërhequr.

Gjykata, në kuptim të nenit 261 e lidhur me neni 387 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.4079/2023, më datë 16.11.2023

G j y q t a r j a
Greta Ibraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të dispozitës së nenit 261 paragrafi 4 të LPK-së, nuk është e lejuar ankesa.